



REMITANCAT – NJË PORTË DREJT ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM

Mësimet e nxjerra nga zbatimi i projektit
Greenback në Kosovë



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO



WORLD BANK GROUP



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Ky raport është produkt i Grupit për Zhvillimin e Sistemeve të Pagesave (PSDG) në Praktikën Globale të Financave, Konkurrueshmërisë dhe Inovacionit të Grupit të Bankës Botërore.

Sekretariati Shtetëror i Zvicrës për Çështje Ekonomike (SECO) ka siguruar financimin për materialin në kuadër të Programit të Remitancave dhe Pagesave.

www.remittanceprices.worldbank.org



Grupi i Bankës Botërore

Rruga: 1818 H Street NW
Uashington, DC 20433 SHBA

www.worldbank.org

paymentsystems@worldbank.org

Nr. i telefonit: +1202 473-1000

© Grupi i Bankës Botërore, 2022

Lidhur me Projektin Greenback

Pavarësisht krizës së shkaktuar nga pandemia COVID-19, remitancat e punëtorëve emigrantë në vitin 2020 kanë kapur shumën e jashtëzakonshme prej 548 miliardë dollarë, dhe parashikohen të arrijnë në 589 miliardë dollarë në vitin 2021. Megjithatë, kostoja e dërgimit të remitancave mbetet e lartë për shumicën e kanaleve të monitoruara të transferit krahasuar me objektivat e vendosura nga G20 dhe OZHQ-të e OKB-së. Ulja e kostove të remitancave dhe rritja e shërbimeve të disponueshme për emigrantët dhe përfituesit e remitancave në mbarë botën mbetet në thelb të agjendës globale të zhvillimit.

Në këtë kontekst, Banka Botërore (BB) është duke zbatuar projektin Greenback në disa vende të botës. Në Kosovë, Banka Botërore ka partneritet me Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK). Kjo nismë synon të rritë efikasitetin e remitancave ndërkombëtare dhe të rritë përfitimet që ato sjellin për familjet individuale dhe ekonominë, kryesisht nëpërmjet edukimit financiar, ngritjes së kapaciteteve dhe koordinimit të palëve të interesit.

Projekti Greenback fillon në komunitetet lokale që veprojnë si laboratorë për analizimin e çështjeve që lidhen me remitancat specifike për komunitetet, duke krijuar dhe pilotuar zgjidhje që mund të rriten për të përfituar si nga ana e ofertës ashtu edhe nga kërkesa e tregjeve të remitancave. Projekti promovon vazhdimisht bashkëpunimin midis palëve të interesit lokale dhe kombëtare, për të mbështetur një ndryshim kuptimplotë.

Megjithëse e kufizuar në shkallë, kjo qasje nga poshtë-lart prodhon mjete dhe mësim të nxjerra, të cilat kanë efekt të konsiderueshëm demonstrues për komunitete të ngjashme, dhe mund të rriten lehtësisht përtej fushëveprimit dhe kohëzgjatjes së përfshirjes së Bankës Botërore në secilin vend.

Ekipi i GBB-së më pas koordinon aktivitetet e shkëmbimit të njohurive përmes Rrjetit të Qyteteve Kampione të Remitancave, duke kopjuar praktikat më të mira dhe duke shpërndarë mësimet e nxjerra në nivel global. Në këtë mënyrë, projekti Greenback shërben si instrument strategjik që bashkon ndërhyrjet lokale dhe globale të Bankës Botërore për remitancat dhe përfshirjen financiare.

Në vitin 2021, projekti Greenback ka mbushur plot 10 vjet. Ky projekt u lancua në vitin 2011, fillimisht duke angazhuar dy komunitete emigrantësh, hondurasit në Uashington DC dhe marokenët në Torino të Italisë. Që prej asaj kohe, projekti është zbatuar në disa vende dërguese dhe pranuese të remitancave, duke përfshirë Francën, Mbretërinë e Bashkuar, Malajzinë, Indonezinë, Haitin dhe katër vende të Ballkanit Perëndimor. Qyteti i Prizrenit në Kosovë është një nga komunitetet lokale ku është pilotuar projekti Greenback brenda një kornize më të gjerë të Programit të Remitancave dhe Pagesave (PRP) të financuar nga Sekretariati Shtetëror i Zvicrës për Çështje Ekonomike (SECO).



Tabela e përmbajtjes

3	LIDHUR ME PROJEKTIN GREENBACK
6	FALËNDERIMET
7	AKRONIMET DHE SHKURTESAT
8	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE
10	HYRJE
11	VËSHTRIM MBI FLUKSET GLOBALE TË REMITANCAVE
	11. Vëllimi i remitancave
	12. Kostoja e dërgimit të remitancave
	12. Remitancat gjatë pandemisë COVID-19
	13. Remitancat në agjendën e zhvillimit global
15	VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I REMITANCAVE NË KOSOVË
	15 Migrimi kosovar dhe flukset e remitancave
	16. Kostoja e dërgimit të remitancave në Kosovë
	17. Ndikimi i COVID-19 në remitancat në Kosovë
19	PUNA E BANKËS BOTËRORE PËR PËRFSHIRJEN FINANCIARE DHE REMITANCAT NË KOSOVË
	19. Përfshirja financiare në Kosovë
	19. Programi i Remitancave dhe Pagesave (PRP)
	20. Projekti Greenback
21	VLERËSIMI I TREGUT DHE NEVOJAVE
	21. Anketat bazë mbi sjelljet financiare të përfituesve të remitancave
	22. Vlerësimi i nevojave për mësim
	23. Vlerësimi i tregut të remitancave
	23. Përfshirja financiare dhe çështja e besimit
	24. Edukimi financiar për pranuesit e remitancave
25	AKTIVITETET E GREENBACK
	26. Modulet e edukimit financiar
	28. Seria e diskutimeve me diasporën për projektin Greenback
	29. Akademia Greenback
	29. Inkorporimi i edukimit financiar në kurrikulën shkollore
30	MËSIMET E NXJERRA DHE RRUGA PËRPARA

FALËNDERIMET

Ky raport nuk do të mund të realizohej pa mbështetjen bujare të Sekretariatit Shtetëror të Zvicrës për Çështje Ekonomike, përmes Programit të Remitancave dhe Pagesave në Ballkan, si dhe bashkëpunimit të shkëlqyer me BQK-në.

Oya Pinar Ardic Alper është Udhëheqëse e Ekipit të Detyrave të Programit të Remitancave dhe Pagesave. Nenad Bosiljčić (Banka Botërore) koordinon projektin në Ballkanin Perëndimor.

Autorë kryesorë të këtij raporti janë Edlira Dashi dhe Jelena Ivančević (Banka Botërore) si dhe Ajshe Ramosaj dhe Bejtush Kijmari (BQK). Gert Zenelaj ka ofruar asistencë në dizajn dhe faqosje.

Ekipi dëshiron gjithashtu të falënderojë Adnan Bahtic, Tarik Limo dhe Viviana Premazzi për kontributin e tyre në zbatimin e suksesshëm të projektit Greenback në Kosovë.

E fundit, por jo më pak e rëndësishme, projekti Greenback në Kosovë nuk do të ishte i mundur pa kontributet dhe angazhimin e Bankës Qendrore të Kosovës dhe autoriteteve të tjera lokale dhe kombëtare në Kosovë. Falënderime të veçanta për mërgimtarët kosovarë dhe familjet e tyre për kohën e tyre dhe për ndarjen e përvojave të tyre.

AKRONIMET DHE SHKURTESAT

BQK	<i>Banka Qendrore e Republikës së Kosovës</i>
EAQ	<i>Evropa dhe Azia Qendrore</i>
IHD	<i>Investimet e Huaja Direkte</i>
BPV	<i>Bruto Produkti Vendor</i>
VAUM	<i>Vendet me të ardhura të ulëta dhe të mesme</i>
VNM	<i>Vlerësimi i nevojave për mësim</i>
OTP	<i>Operatori për Transfer të Parave</i>
NZZH	<i>Ndihma Zyrtare për Zhvillim</i>
PRP	<i>Programi për Remitancë dhe Pagesa</i>
ÇRB	<i>Çmimet e Remitancave në Botë</i>
OSHR	<i>Ofruesi i Shërbimit të Remitancave</i>
OZHQ	<i>Objektivat për Zhvillim të Qëndrueshëm</i>
SECO	<i>Sekretariati Shtetëror i Zvicrës për Çështje Ekonomike</i>
OKB	<i>Organizata e Kombeve të Bashkuara</i>
BB	<i>Banka Botërore</i>

Përmbledhje ekzekutive

Remitancat ndërkombëtare kanë ndikim substancial në ekonominë në zhvillim. Përveç mbajtjes financiare të familjeve individuale, remitancat kanë edhe efekte pozitive makroekonomike si burim thelbësor i financimit të jashtëm. Ato ulin deficitin e bilancit të pagesave, rritin rezervat në valuta të huaja, zbutin varfërinë dhe mbështetin rritjen nëpërmjet efekteve shumëfishuese direkte dhe indirekte.

Në vitin 2021, remitancat arritën shumën e jashtëzakonshme prej 589 miliardë dollarë të dërguara në vendet me të ardhura të ulëta dhe të mesme (VAUM) sipas vlerësimeve të BB-së - më shumë se trefish mbi Ndhmën Zyrtare për Zhvillim (NZZH) dhe duke përjashtuar Kinën, më shumë se 50% më të larta se Investimet e Huaja Direkte (IHD).¹

Si përqindje e Bruto Produktit Vendor (BPV), Kosova zë vendin e parë si vend pranues i remitancave në Evropë. Flukset hyrëse të remitancave vlerësohen të kenë arritur vlerën prej 1.5 miliardë dollarë në vitin 2021, duke përbërë 16.7 për qind të BPV-së së Kosovës. Popullsia me prejardhje nga Kosova që jeton jashtë vendit (diaspora), në vitin 2017 vlerësohet të jetë 833,739 persona, që është e barabartë me 46.36 për qind të njerëzve që jetojnë në Kosovë.²



Pandemia COVID-19 ka ngadalësuar migrimin e ri dhe ka rritur migrimin e kthimit për herë të parë në historinë moderne. Kjo ka vënë në sprovë sektorin e remitancave dhe ka bërë që flukset e remitancave të bien gjatë muajve mars dhe prill 2020. Megjithatë, flukset e remitancave janë rikuperuar në muajt në vijim të vitit 2020 dhe gjatë gjithë vitit 2021, pasi emigrantët vazhduan të dërgojnë para në shtëpitë e tyre, duke grumbulluar nga kursimet e tyre ose fondet tjera emergjente në të cilat kanë pasur qasje.

Në Kosovë, remitancat u rritën për 15% në vitin 2020 krahasuar me një vit më parë, duke u dëshmuar si burim kundërciklik dhe i qëndrueshëm i të ardhurave për familjet në kohë krize.³

¹ Banka Botërore. (2021) Migration and Development Brief 35 (Raporti 35 mbi Migrimin dhe Zhvillimin). Uashington D.C.: Grupi i Bankës Botërore.

² Autoriteti Qeveritar për Migrim. (2018) Profil i zgjeruar i migrimit 2013-2017. Prishtinë. Qeveria e Republikës së Kosovës

[https://mpb.rks-gov.net/Uploads/Documents/Pdf/EN/41/EXTENDED%20MIGRATION%20PROFILE%202013-2017_final%20II%20\(1\).pdf](https://mpb.rks-gov.net/Uploads/Documents/Pdf/EN/41/EXTENDED%20MIGRATION%20PROFILE%202013-2017_final%20II%20(1).pdf)

³ Banka Botërore. (2021) Migration and Development Brief 35 (Raporti 35 mbi Migrimin dhe Zhvillimin). Uashington D.C.: Grupi i Bankës Botërore.

Njëkohësisht, rëndësia e remitancave si burim i financimit të jashtëm për të gjitha VAUM-të, duke përfshirë edhe Kosovën, u bë gjithnjë e më e rëndësishme teksa u dobësua ekonomia vendore e brishtë dhe u zvogëluan format e tjera të financimit të jashtëm.

Kostoja e dërgimit të remitancave mbetet e lartë për shumicën e kanaleve të monitoruara të transferit në krahasim me objektivat e vendosura nga G20 dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ-të) të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB), si në nivel global ashtu edhe në Kosovë. Vëllime të mëdha të remitancave ende janë duke u transportuar si para të gatshme në dorë përtej kufijve, duke shkaktuar probleme të lidhura me sigurinë dhe efikasitetin. Qasja në shërbime më të përballueshme, të sigurta dhe efikase të transferit të parave mbetet e kufizuar për shumë emigrantë dhe përfitues të remitancave për shkak të mungesës së dokumenteve të identifikimit, rregulloreve të rrepta kundër pastrimit të parave dhe kundër financimit të terrorizmit (AML/CFT), mungesës së produkteve financiare ose infrastrukturës në dispozicion, ose niveleve të dobëta të përfshirjes dhe edukimit financiar.

Ulja e kostos së lartë të remitancave dhe rritja e përfshirjes financiare të emigrantëve dhe përfituesve të remitancave në mbarë botën mbetet në qendër të agjendës së zhvillimit global. Në këtë kontekst, Banka Botërore (BB) ka zbatuar Programin e Remitancave dhe Pagesave (PRP) të financuar nga Sekretariati Shtetëror i Zvicrës për Çështje Ekonomike (SECO) në vende të caktuara të Evropës dhe Azisë Qendrore (EAQ), duke përfshirë edhe Republikën e Kosovës. PRP promovon kanale dhe instrumente me kosto efikase të qasjes për shpërndarjen e remitancave ndërkombëtare. Në kuadër të kornizës së PRP-së, projekti Greenback është komponenti i edukimit financiar dhe ngritjes së kapaciteteve.

Projekti Greenback nxitë ndryshime të motivuara nga nevojat reale të përfituesve të remitancave, si në vendet dërguese ashtu edhe në ato pranuese. Nëpërmjet përfshirjes së drejtpërdrejtë të punëtorëve emigrantë dhe familjeve të tyre, autoriteteve lokale dhe ofruesve të shërbimeve të remitancave, projekti synon t'i adresojë nevojat specifike të pagesave dhe financiare të pranuesve të remitancave nëpërmjet edukimit financiar, rritjes së ndërgjegjësimit dhe koordinimit të tregut dhe të palëve të interesit. Projekti ndihmon në përmirësimin e tregut të remitancave dhe i bën shërbimet financiare më të qasshme, të përballueshme dhe tërheqëse për punëtorët emigrantë dhe familjet e tyre në vendlindje, duke demonstruar se si mund të përdoren remitancat për të rritur përfshirjen financiare dhe për të nxitur zhvillimin. Mjetet kryesore të qasjes Greenback janë edukimi financiar i klientëve fundorë, ngritja e kapaciteteve të ofruesve të shërbimeve financiare, angazhimi dhe koordinimi i palëve të interesit.

Në kuadër të projektit, në Kosovë janë realizuar një sërë aktivitetesh, të cilat kanë prodhuar rezultatet e mëposhtme:

- (i)** analizimi dhe përmbledhja e sjelljeve financiare dhe nevojave të të mësuarit të dërguesve dhe pranuesve të remitancave, duke informuar veprimet e mëtejshme.
- (ii)** ndërgjegjësimi i individëve në Kosovë dhe në diasporë për rëndësinë e remitancave, përfshirjen financiare, edukimin financiar dhe potencialin e tyre zhvillimor, duke krijuar më shumë fokus në këto tema dhe duke dhënë një shtysë për një ndryshim domethënës.
- (iii)** pilotimi i programeve për ngritjen e kapaciteteve dhe besimi i tyre te palët kombëtare të interesit për t'i zhvilluar dhe përmirësuar më tej, duke rritur kështu edhe përpjekjet

Më tej, në Kosovë nevojitet një fokus i shtuar për t'i bërë shërbimet e rregulluara më tërheqëse për përdoruesit fundorë për sa i përket qasjes dhe kostos. Për këtë qëllim është me rëndësi jetike që të njihet dhe të bëhet dallimi midis nevojave specifike të secilit grup të synuar, siç janë emigrantët, gratë, popullatat rurale, etj. Duke realizuar potencialin e shërbimeve financiare digjitale, palët e interesit të këtij sektori mund të bashkëpunojnë me qëllim të krijimit të një tregu nxitës, të mbështetur me një kornizë ligjore mundësuese dhe me një infrastrukturë të përshtatshme e cila maksimizon konkurrencën dhe hyrjen në treg.

Hyrje

Miliona ekonomi familjare anembanë globit varen nga remitancat, një burim i të ardhurave të ekonomive familjare që vijnë nga anëtarët e familjes që kanë emigruar në vende më të zhvilluara për arsye ekonomike ose të tjera. Remitancat e emigrantëve përfaqësojnë në mënyrë kumulative flukse hyrëse esenciale financiare për shumë ekonomi në zhvillim, duke tejkaluar shumën e IHD-ve dhe NZZH-së në shumicën e VAUM-ve.



Kosova është vendi i ranguar më së larti për pranimin e remitancave në Evropë në përqindje të BPV-së. Në vitin 2017, BB-ja, në partneritet me BQK-në, ka filluar të hetojë tregun vendor për remitancat ndërkombëtare dhe ka përcaktuar fushat kryesore të ndërhyrjes, që do të zbatoheshin brenda kornizës së asistencës teknike të PRP-së.

PRP synon të rritë efikasitetin e tregut të remitancave në Kosovë, si dhe të rritë përfitimet nga remitancat për familjet individuale dhe ekonomitë e tëra. Programi nxitë ndryshime në anët e ofertës dhe kërkesës, që mund t'u përgjigjen nevojave reale të përfituesve përfundimtarë të remitancave - punëtorëve emigrantë, familjeve dhe komuniteteve të tyre.

Një komponent i PRP-së, i titulluar projekti Greenback, fokusohet në zhvillimin e edukimit financiar të përshtatur për përfituesit e remitancave. Ai synon forcimin e kapaciteteve të tyre për vendimmarrje financiare dhe shfrytëzimin e shërbimeve financiare të rregulluara për mirëqenien financiare personale. Aktivitetet kryesore përfshijnë zhvillimin dhe pilotimin e moduleve të edukimit financiar, aktivitetet për rritjen e ndërgjegjësimit, ngritjen e kapaciteteve të palëve të interesit dhe angazhimin dhe koordinimin e tregut.

Ky raport synon të informojë një audiencë më të gjerë për rëndësinë e remitancave dhe aktivitetet specifike të edukimit financiar të zbatuara në Kosovë, me qëllim të përmirësimit të efikasitetit të tyre. Ai prezanton shkurtimisht flukset e remitancave ndërkombëtare dhe rolin e tyre në agjendën e zhvillimit global, me një fokus të veçantë në ndikimin e pandemisë COVID-19. Kapitujt në vijim ofrojnë një përmbledhje të punës së BB-së mbi përfshirjen financiare dhe remitancat ndërkombëtare në Kosovë, me theks të veçantë në projektin Greenback, si dhe paraqesin kontekstin lokal për zbatimin e projektit. Kapitujt e fundit fokusohen në aktivitetet e zbatuara në Kosovë dhe sugjerojnë rrugën përpara bazuar në mësimet e nxjerra.

Për më shumë informata lidhur me punën e Bankës Botërore për zvogëlimin e kostove të remitancave, projektin Greenback dhe Programin e Remitancave dhe Pagesave në Ballkanin Perëndimor, ju lutemi vizitoni faqen: <http://remittanceprices.worldbank.org/>

Vështrim mbi flukset globale të remitançave

Miliona njerëz anembanë globit udhëtojnë në vende të tjera në kërkim të perspektivave më të mira të punës. Shpesh, të ardhurat që ata fitojnë jashtë vendit u shërbejnë si për nevojat e tyre personale ashtu edhe për nevojat e familjeve të tyre në vendlindje. Edhe pse transaksionet individuale që ata dërgojnë në shtëpi janë relativisht të vogla në vlerë, në total, ato arrijnë në qindra miliarda dollarë të dërguar çdo vit. Këto transfere ndërkufitare të parave, nga personi në person, quhen remitanca ndërkombëtare.

Remitancat janë një mjet shpëtimi për miliona familje të varfra dhe të cenueshme në mbarë botën. Shumë ekonomi familjare i pranojnë ato rregullisht dhe varen prej tyre për nevojat e tyre bazike, duke përbërë kështu 50% ose më shumë të të ardhurave të tyre mujore. Të tjerët i pranojnë ato vetëm për raste të veçanta ose në raste urgjente, ndërsa më pak sosh ende pranojnë remitanca të planifikuara posaçërisht për blerje të mëdha ose për investime në aktivitete ekonomike.

Përveç mbështetjes me të ardhura individuale të ekonomive familjare dhe bizneseve të vogla, këto fonde kanë një ndikim të matshëm në ekonomi të tëra. Remitancat zvogëlojnë deficitet tregtare dhe të llogarive rrjedhëse, rritin rezervat në valuta të huaja, zbutin varfërinë dhe mbështetin rritjen nëpërmjet efekteve të shumfishta direkte dhe indirekte


Vëllimi i remitançave

Në vitin 2021, BB-ja ka vlerësuar flukset globale të remitançave në VAUM në një shumë marramendëse prej 589 miliardë dollarë, duke shënuar kështu një rritje prej 7.3 për qind krahasuar me vitin 2020. Projektionet aktuale parashohin rritje të mëtejshme në vitin 2022, por me një ritëm më të ngadaltë.⁴

Vëllimi aktual i remitançave është më shumë se trefishi mbi NZZH dhe duke përjashtuar Kinën, më shumë se 50% më i lartë se IHD-të.⁵ Për shumicën e vendeve në zhvillim, remitancat tejkalojnë shumën e IHD-ve dhe NZZH-së. Përveçse janë më të mëdha në vëllim, remitancat kanë gjithashtu ndikim më të menjëhershëm sesa këto burime të tjera të financimit të jashtëm, sepse ato shkojnë drejtpërdrejt në duart e familjeve individuale.

Siç shihet në Figurën 1 më poshtë, remitancat përbëjnë deri në 44 për qind të BPV-së në vendet që mbështeten më së shumti në këto flukse hyrëse. Kosova është e 15-ta në mesin e VAUM sa i përket përqindjes së flukseve të remitançave në BPV-në e saj

Figure 1. Remitancat si përqindje e BPV-së, %, 2021



⁴ Banka Botërore. (2021) Migration and Development Brief 35 (Raporti 35 mbi Migrimin dhe Zhvillimin). Uashington D.C.: Grupi i Bankës Botërore

⁵ Banka Botërore. (2021) Migration and Development Brief 35 (Raporti 35 mbi Migrimin dhe Zhvillimin). Uashington D.C.: Grupi i Bankës Botërore

Kostoja e dërgimit të remitancave

Dërgimi i remitancave shoqërohet me një kosto që mund të jetë mjaft e lartë, në varësi të llojit të shërbimit të përdorur për t'i qarkulluar paratë përtej kufijve. Mesatarja globale në TM3 të vitit 2021 ishte 6.3 për qind, më shumë se dyfishi i caktuar të OZHQ-së prej 3% të shumës së dërguar. Sipas BB-së, bankat kanë qenë ofruesit më të shtrenjtë të shërbimeve, me një kosto mesatare globale prej 10.40 për qind.⁶ Kjo shumë është 20.8 dollarë për tarifën që dërguesit duhej të paguanin për dërgimin e 200 dollarëve të familjet e tyre në vendlindje.

Për të shmangur pagesën e tarifave të larta, emigrantët shpesh sjellin para vetë kur kthehen në vendlindje ose i dërgojnë ato përmes palëve të treta – anëtarëve të tjerë të familjes, miqve apo edhe shoferëve të autobusëve. Megjithatë, transferet e kryera me dorë janë shumë të ndjeshme ndaj pengesave në udhëtimet ndërkufitare të shkaktuara nga mbylljet ose llojeve të ndryshme të krizave. Për më tepër, paratë e tyre janë gjithmonë në rrezik për t'u humbur, vjedhur ose konfiskuar në kufi. Transporti me dorë nëpërmjet palëve të treta është gjithashtu mjaft i papërshtatshëm sepse të tjerët përcaktojnë kohën dhe vendin e dërgimit dhe dorëzimit në vend të dërguesit dhe marrësit.

Si mjaft premtuese, teknologjitë e reja mundësojnë shërbime të dërgesave që janë të sigurt, të lira dhe shumë të përshtatshme. Në TM3 të vitit 2021, "Mobile Money" ka qenë instrumenti më pak i kushtueshëm për dërguesit për t'i financuar transaksionet, ndërsa për pranuesit për t'i pranuar remitancat.

Sidoqoftë, shumë punëtorë emigrantë dhe akoma më shumë pranues të remitancave në mbarë globin nuk kanë qasje në shërbimet digjitale të remitancave, kryesisht për shkak të varfërisë, mungesës së edukimit financiar dhe digjital, si dhe përjashtimit financiar, e ku të gjitha këto janë çështje në qendër të agjendës së zhvillimit global.

Remitancat gjatë pandemisë COVID-19

Pandemia globale COVID-19 ka shkaktuar një krizë të paprecedentë socio-ekonomike, e krahasueshme vetëm me përhapjen dhe ndikimin e gripit spanjoll gati një shekull më parë. Emigrantët dhe familjet e tyre kanë qenë ndër më të goditurit nga kjo krizë. Të goditur nga mbylljet, masat e distancës sociale dhe rreziqet shëndetësore, emigrantët ishin ndër të parët që humbën punën dhe përfitimet e tyre në vendet pritëse, më pak ose aspak opsione për lëvizshmëri ose mbrojtje sociale dhe më pak mundësi për t'i mbështetur familjet e tyre në vendlindje.

Flukset e remitancave janë zakonisht kundërciklike, me emigrantët që dërgojnë më shumë para kur situata bëhet e vështirë. Megjithatë, për shkak të përmasës globale të kësaj krize, ajo goditi njëkohësisht vendet dërguese dhe ato pranuese të remitancave, si dhe rrezikoi si burimet ashtu edhe transferet e remitancave, duke kërcënuar të ulë ndjeshëm flukset globale dhe të shtyjë familjet dhe ekonomitë e varura nga remitancat drejt situatave të vështira. Për më tepër, zvogëlimi i remitancave mund të kthejë prapa progresin e shënuar në Agjendën 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm dhe OZHQ-të.

Në fillim të pandemisë, BB-ja ka parashikuar një rënie të madhe prej 20 për qind të flukseve të remitancave në vitin 2020.⁷ Më vonë, ky projeksion u ndryshua në një projeksion shumë më pak pesimist, kryesisht për shkak të efekteve pozitive të masave fiskale për stabilizimin e ekonomive dhe sigurimin e vendeve të punës në shumë prej vendeve dërguese të remitancave.

Përfundimisht, flukset e remitancave drejt VAUM-ve ranë për vetëm 1.7 për qind në vitin 2020 krahasuar me një vit më parë, pavarësisht recesionit të rëndë global. Nëse i krahasojmë, IHD-të kundrejt VAUM-ve janë tkurrur për mbi 30 për qind gjatë së njëjtës periudhë. Në vitin 2021, flukset e remitancave iu kthyen rritjes dhe sipas BB-së vlerësohen të jenë rritur për 7.3 për qind. Ky trend pritet të vazhdojë edhe në vitin e ardhshëm.⁸

Përshpejtimi i digjitalizimit, i vërejtur në shumë aspekte të jetës gjatë kësaj krize, duke përfshirë industrinë e

⁶ Banka Botërore. (2021) Remittance Prices Worldwide Quarterly (Çmimet tremujore të remitancave në botë). Publikimi 39 (shtator 2021), Uashington D.C.: Banka Botërore.

⁷ Banka Botërore. (2021) Migration and Development Brief 33 (Raporti 33 mbi Migrimin dhe Zhvillimin). Uashington D.C.: Grupi i Bankës Botërore.

⁸ Për të gjitha shifrat në këtë paragraf, ju lutemi shihni (2021) Migration and Development Brief 34 (Raporti 34 mbi Migrimin dhe Zhvillimin), Uashington D.C.: Banka Botërore.

remitancave, ka ndikuar pozitivisht në flukset e remitancave gjatë pandemisë COVID-19. Rritja e përdorimit të remitancave digjitale iu ka kundërvu zvogëlimit të flukseve të remitancave si para të gatshme të dërguara me dorë por të ndaluara nga mbylljet dhe ndalimet e udhëtimit, si dhe ka ndihmuar në uljen e kostos së remitancave.

Emigrantët me qasje në shërbimet financiare digjitale ishin të pozicionuar më së miri për të përballuar stuhinë dhe për të vazhduar me dërgimin e remitancave. Paralelisht me këtë, familjet pranuese të remitancave të pajisura për të përdorur shërbime digjitale kishin mundësi të pranonin para nga jashtë pa asnjë ndërprerje, ndryshe nga ato që duhej të mbështeteshin në pagesat në para të gatshme. Shërbimet digjitale kanë qenë veçanërisht të përshtatshme, nëse jo jetike, gjatë periudhës së mbylljes.

Transferet digjitale të remitancave ndihmuar gjithashtu dërguesit dhe pranuesit të mbeten të shëndetshëm duke shmangur rreziqet e qarkullimit nëpër duar të parave të gatshme dhe kontakteve të panevojshme fizike me persona të tjerë në banka ose zyrat e operatorit të transferit të parave (OTP). Në të njëjtën kohë, remitancat digjitale kanë qenë më të lira se shërbimet e remitancave për qarkullimin e parave të gatshme.

Remitancat në agjendën e zhvillimit global

Në fillim të viteve 2000, GBB ndihmoi për të sjellë në vëmendjen e politikëbërësve dhe komunitetit të ekspertëve përmasat dhe rëndësinë e zhvillimit të remitancave, dhe që nga ajo kohë, ka qenë në krye të agjendës globale të remitancave. GBB ka bashkëpunuar me organet e përcaktimit të standardeve për të zhvilluar parime udhëzuese që synojnë të përmirësojnë efikasitetin e tregut për remitancat ndërkombëtare dhe ka kontribuar në rritjen e mbledhjes së të dhënave mbi flukset dhe çmimet e remitancave.

Çmimet e Remitancave në Botë (ÇRB) është një platformë që GBB e ka krijuar në vitin 2008 me qëllim të monitorimit të çmimeve të remitancave. Numri i kanaleve të remitancave të monitoruara ka shkuar duke u rritur me kalimin e viteve, ndërsa aktualisht ka 367 korridore në mesin e 48 vendeve dërguese dhe 105 vendeve pranuese.⁹ Çmimet ekzaminohen çdo tremujor përmes blerjeve misterioze nga Ofruesit e Shërbimeve të Remitancave (OSHR) në të gjitha rajonet gjeografike.

Krahas ÇRB, disa vende kanë krijuar bazat e tyre kombëtare të të dhënave për monitorimin e çmimeve që përputhen me standardet e GBB. Qëllimi i këtyre bazave të të dhënave është të gjurmojë progresin drejt objektivave globale të uljes së kostos së remitancave duke stimuluar konkurrencën në treg dhe transparencën, si dhe duke ndihmuar emigrantët dhe familjet e tyre të bëjnë zgjedhje të informuara për kanalet e transferit.

Duke zvogëluar kostot e remitancave, çdo vit mund të kursehen miliarda dollarë dhe të orientohen drejt arritjes së një ndikimi substancial për rritje dhe për zbutjen e varfërisë në vendet në zhvillim. BB ka luajtur rol të rëndësishëm për vendosjen e cakut të parë global "për të ulur koston e shërbimeve të remitancave me pesë pikë përqindjeje në pesë vitet e ardhshme (Objektivi 5x5)", i miratuar nga G8 në vitin 2009 dhe G20 në vitin 2011. Më vonë, OZHQ-të e OKB-së përcaktuan një cak edhe më ambicioz - deri në vitin 2030, kostoja mesatare e remitancave të zvogëlohet në më pak se 3 për qind dhe të eliminohen korridoret e remitancave me tarifa totale më të larta se 5 për qind. Për më tepër, OZHQ-të synojnë të rritin vëllimin e remitancave si përqindje e BPV-së, si burim financimi për mbështetjen e proceseve të zhvillimit dhe për të zvogëluar pabarazitë brenda vendit dhe ndërmjet vendeve të ndryshme.


Që nga miratimi i objektivave të uljes së kostos, çmimi për dërgim të remitancave ka rënë. Në TM1 të vitit 2009, kostoja esatare globale¹⁰ për dërgimin e 200 dollarëve ka qenë 9.67 për qind, ndërsa në TM3 të vitit 2021, u regjistrua në 6.30 për qind. Mesatarja globale e remitancave digjitale është regjistruar për herë të fundit në 4.99 për qind, ndërsa Mesatarja globale për remitancat jodigjitale ka qenë 6.77 për qind. Prandaj, shërbimet digjitale më në fund kanë arritur objektivin 5x5, por ato përbëjnë vetëm 27 për qind të të gjitha shërbimeve që ÇRB i ka mbledhur në TM2 të vitit 2021 (Figura 2).¹¹

⁹ Banka Botërore. (2021) Çmimet e Remitancave në Botë. <https://remittanceprices.worldbank.org/en>

¹⁰ Mesatarja Globale është një mesatare e thjeshtë e kostove të të gjitha kanaleve individuale transparente të monitoruara përmes ÇRB

¹¹ Banka Botërore. (2021) Remittance Prices Worldwide Quarterly (Çmimet tremujore të remitancave në botë). Publikimi 39, shtator 2021.

Figure 2. Trendet në koston globale për dërgimin e 200 dollarëve, në %



Burimi: Banka Botërore. Çmimet tremujore të remitancave në botë. Publikimi 39, shtator 2021

Krahas uljes së koston së remitancave, agjenda për zhvillimin global synon gjithashtu të rritë përfshirjen financiare të punëtorëve emigrantë dhe përfituesve të remitancave, duke hequr barrierat dhe duke promovuar mundësitë për zgjerimin e qasjes dhe përdorimit të shërbimeve financiare.

Përfshirja financiare është një mjet esencial për të përballuar dhe për t'i shpëtuar varfërisë, prandaj OZHQ-të e OKB-së e perceptojnë atë si faktor kritik për përmirësimin e gjendjes së pjesëve më të cenueshme të shoqërisë. Personat që nuk janë pjesë e ndonjë banke nuk kanë llogari transaksionesh, nuk kanë qasje në sigurime apo kredi dhe nuk kanë mbrojtje për paratë e tyre nga vjedhja ose humbja. Mungesa e qasjes në shërbimet financiare i lë njerëzit me masa mbrojtëse të kufizuara nëse humbasin punën ose sëmuren. Gjithashtu i vë ata në rrezik të huadhënësve grabitqarë.

Remitancat mund të përdoren për të rritur përfshirjen financiare të dërguesve dhe pranuesve të remitancave. Ato mund të shërbejnë si një portë për t'iu qasur produkteve dhe shërbimeve të tjera financiare. Zgjerimi i qasjes në llogaritë bankare për më shumë emigrantë dhe përfitues të remitancave mund të mundësojë digjitalizimin e mëtejshëm të shërbimeve financiare, duke përfshirë shërbimet e remitancave, gjë që rrit efikasitetin e remitancave.¹²

Remitancat gjithashtu mund të ofrojnë financim inovativ. Efektiviteti i këtyre fondeve mund të rritet ndjeshëm duke i orientuar ato drejt zhvillimit dhe investimeve produktive dhe jo konsumit. Gjithashtu, orientimi i flukseve të remitancave përmes kanaleve të rregulluara forcon infrastrukturën ekonomike të vendeve pranuese dhe krijon rrjedha shtesë të të ardhurave të sektorit financiar.

¹² CPMI dhe Banka Botërore (2016). Payment Aspects of Financial Inclusion (Aspektet e pagesës të përfshirjes financiare). Bazel: Banka për Shlyerjet Ndërkombëtare, dhe Uashington DC: Banka Botërore.

Vështrim i përgjithshëm i remitancave në Kosovë

Migrimi kosovar dhe flukset e remitancave

Përkundër faktit që rritja ekonomike e Kosovës në dekadën e fundit ka tejkalaru fqinjët e saj dhe ka qenë kryesisht gjithëpërfshirëse, ajo nuk ka qenë e mjaftueshme për të siguruar mjaftueshëm vende pune formale, sidomos për gratë dhe të rinjtë ose për të ulur ndjeshëm shkallën e lartë të papunësisë. Modeli i rritjes së Kosovës mbështetet fuqishëm në remitanca për të nxitur konsumin e brendshëm.¹³ Megjithëse remitancat arrijnë rreth 20-25 për qind të familjeve dhe ofrojnë të ardhura të konsiderueshme për familjet më të varfra, ato janë përdorur kryesisht për konsum.¹⁴

Për dekada me radhë, qytetarët kosovarë kanë migruar për shumë arsye, duke filluar nga ikja nga lufta dhe persekutimi politik deri te papunësia dhe varfëria. Që nga shpallja e pavarësisë së Kosovës në shkurt 2008, trendi në rritje i emigrimit ka qenë kryesisht i motivuar nga punësimi, arsimimi dhe bashkimi familjar.



Mbi tridhjetë për qind e popullsisë së Kosovës jeton anë e mbanë globit, kryesisht të përqendruar në Gjermani, Zvicër, Itali, Slloveni, Austri, Shtetet e Bashkuara, Francë, Suedi, Mbretërinë e Bashkuar dhe Belgjikë.¹⁵

Për gjashtë vite radhazi, fluksi hyrës i remitancave në Kosovë ka pasur një rritje të vazhdueshme, duke arritur në 1.5 miliardë dollarë në vitin 2021.¹⁶ Vëllimet më të konsiderueshme vijnë nga Gjermania dhe Zvicra, që përbëjnë më shumë se gjysmën e fluksit të përgjithshëm hyrës. Sipas vlerësimeve të BB-së, remitancat e brendshme përbëjnë 16.7 për qind të BPV-së së Kosovës, duke e ranguar atë në vendin e parë në Evropë sa i përket pranimit të remitancave sipas përqindjes në BPV dhe në vendin e tretë në EAQ, vetëm pas Republikës së Kirgistanit dhe Taxhikistanit me 30.1 dhe 27.8 për qind të BPV-së, respektivisht.¹⁷

¹³ Banka Botërore. Kosovo Overview (Vështrim i Përgjithshëm për Kosovën). Përditësuar për herë të fundit më: 8 prill 2021, dhe i qasur më 06 dhjetor 2021 në <https://www.worldbank.org/en/country/kosovo/overview#1>

¹⁴ Banka Botërore. Republic of Kosovo Systematic Country Diagnostic (Diagnostifikimi sistematik i Republikës së Kosovës) (2017). Grupi i Bankës Botërore <https://openknowledge.worldbank.org/bitstream/handle/10986/26573/Kosovo-SCD-FINAL-May-5-C-05052017.pdf>

¹⁵ <https://www.knomad.org/data/migration/emigration>, qasur më 06 dhjetor 2021


¹⁶ <https://www.knomad.org/data/migration/emigration>, qasur më 06 dhjetor 2021

¹⁷ Banka Botërore. (2021) Migration and Development Brief 35 (Raporti 35 mbi Migrimin dhe Zhvillimin). Uashington, D.C.: Grupi i Bankës Botërore.

Kostoja e dërgimit të remitancave në Kosovë

Në TM3 2021, kostoja e dërgimit të 200 dollarëve në Kosovë shënoi një rekord të ulët prej 5.92 për qind, më pak se mesatarja për Evropën dhe Azinë Qendrore (6.55 për qind) dhe mesatarja globale (6.3 për qind) (Figura 3).


Figura 3 Trendet në koston globale të dërgimit të 200 dollarëve, %



Burimi: Çmimet e remitancave në botë, Banka Botërore

Italia dhe Zvicra janë korridorët më të shtrenjta për në Kosovë me mesatarisht 6.76 për qind dhe 6.45 për qind përkatësisht në TM3, 2021. Kostoja e dërgimit të remitancave në Kosovë ka rënë për korridorin e Italisë dhe është ulatur për korridorin e Zvicrës. Kostoja e dërgimit të remitancave duket të jetë më e ulët në korridorët ku nuk ka nevojë për konvertim në valutë, p.sh. nga Gjermania në Kosovë, krahasuar me nga Zvicra në Kosovë (Figura 4).


Figura 4. Kostoja mesatare e dërgimit të 200 dollarëve në Kosovë, sipas shtetit dërgues



Burimi: Çmimet e remitancave në botë, Banka Botërore

Operatorët e transferit të parave (OTP-të) janë ofruesi më i lirë i shërbimeve të remitancave në Kosovë me një kosto mesatare prej 5.28 për qind në TM3, 2021. Bankat po ashtu ofrojnë shërbime të remitancave, por normat e tyre janë më shumë se dyfish, të matura në 11.72 për qind në të njëjtën periudhë. Posta dhe operatorët e parave përmes mobilit aktualisht nuk ofrojnë shërbime të remitancave në Kosovë (Figura 5).


Figura 5. Kostoja mesatare e dërgimit të 200 dollarëve në Kosovë, sipas llojit të OSHR-ve



Burimi: Çmimet e remitancave në botë, Banka Botërore

Të disponueshme për korridoret e Austrisë dhe Zvicrës, shërbimet digjitale të remitancave ofrojnë kosto dukshëm më të ulët për dërgimin e remitancave në Kosovë. Këto shërbime kanë qenë në dispozicion për korridorin Zvicër - Kosovë për së paku tash e katër vjet dhe vetëm në vitin e kaluar për korridorin Austri - Kosovë (Figura 6).

Figura 6. Kostoja mesatare e dërgimit të 200 dollarëve në Kosovë, sipas llojit të transaksionit



Burimi: Çmimet e remitancave në botë, Banka Botërore

Ndikimi i COVID-19 në remitanca në Kosovë

Nga marsi deri në qershor 2020, BB-ja organizoi një anketë globale mbi ndikimin e parashikuar të krizës në tregun e remitancave dhe strategjitë e zbutjes së sektorit. Tri banka qendrore nga vendet e PRP-së morën pjesë - Shqipëria, Kosova dhe Ukraina. Tregu i remitancave u godit ndjeshëm nga kriza në këto vende edhe pse rregullatorët dhe ofruesit e shërbimeve financiare arritën të sigurojnë vazhdimësinë e biznesit dhe të konsiderojnë ofruesit e shërbimeve të remitancave si shërbime esenciale

Ndalimet e udhëtimit dhe mbylljet e ashpra të vendosura në shumë vende të destinacionit për emigrantët e Kosovës, i bënë transaksionet e bazuara në para të gatshme të vështira për t'u ekzekutuar dhe transferet joformale të dorëzuara personalisht të pamundura për t'u kryer. Ata që ishin mbështetur në kanale të parregulluara tani duhej të kalonin në shërbime të rregulluara, që në shumë raste nënkuptonte më shumë kërkesa, si dokumentet e vendbanimit, pronësia e llogarisë bankare, kostot, etj. Për të inkurajuar përdorimin e këtyre kanaleve, bankat qendrore kanë marrë një sërë masash mundësuese.

Pas uljes fillestare të flukseve hyrëse, remitancat në Kosovë u rikuperuan shpejt dhe përmbyshën trendin, duke arritur rritje dyshifrore nga maji e tutje. Flukset hyrëse të remitancave në Kosovë u rritën për 15.1 për qind në vitin 2020, një trend kundërciklik në dritën e sfidave socio-ekonomike të shpërthimit të pandemisë COVID-19. Ky trend është edhe më i dukshëm duke pasur parasysh se remitancat në EAQ ranë për 9.7 për qind në vitin 2020.¹⁸



Sipas BQK-së, shumica e remitancave (68.6 për qind) kanë ardhur përmes agjencive për transferin e parave, të cilat shënuan rritje prej 60.0 për qind. Remitancat e dërguara përmes bankave u rritën për 14.9 për qind, ndërsa remitancat përmes 'kanalit joformal' u ulën për 46.0 për qind për shkak të mbylljes së kufijve dhe kufizimeve tjera.¹⁹

Kostoja e dërgimit të 200 dollarëve në Kosovë u luhet gjatë vitit të parë të pandemisë, por përfundimisht ra në vitin 2021 pasi OTP-të ulën më tej kostot e tyre për afër 0.7 pikë përqindjeje. Në TM1 2021, kostoja mesatare e remitancave në Kosovë arriti një përqindje rekorde të ulët prej 6.47 për qind dhe ra nën mesataren rajonale të EAQ-së.²⁰

Për të siguruar rrjedhën e qëndrueshme të remitancave dhe përdorimin e tyre për të zbutur ndikimin e rënies ekonomike, bashkësia ndërkombëtare doli me një sërë rekomandimesh. Për këtë qëllim, rregullatorët e Kosovës, autoritetet dhe OSHR-të morën disa hapa domethënës për të adresuar dhe parandaluar disa nga efektet e pandemisë në tregun e remitancave.

Në aspektin rregullativ dhe të infrastrukturës, BQK-ja është duke përditësuar Ligjin për Bankat për të inkorporuar direktivën e rikuperimit dhe zgjidhjes bankare dhe Ligjin për Sistemet e Pagesave për të transpozuar Direktivën për Paratë Elektronike (EMD) PSD2 dhe direktivat e llogarisë së pagesave. Mbi përdorimin dhe përvetësimin e shërbimeve financiare, BQK-ja është duke zhvilluar një seri të moduleve të edukimit financiar në kuadër të projektit Greenback për të promovuar rritjen e përdorimit të shërbimeve të rregulluara të remitancave dhe shërbimeve digjitale financiare.

¹⁸ Banka Botërore. (2021) Migration and Development Brief 35 (Raporti 35 mbi Migrimin dhe Zhvillimin). Uashington, D.C.: Grupi i Bankës Botërore.

¹⁹ Banka Qendrore e Republikës së Kosovës. (2021) Raporti Vjetor 2020. Prishtinë

²⁰ Banka Botërore. (2021) Çmimet e remitancave në botë. <https://remittanceprices.worldbank.org/en>

Puna e Bankës Botërore për përfshirjen financiare dhe remitancat në Kosovë

Përfshirja financiare në Kosovë

Përfshirja financiare mbetet sfidë në Kosovë. Me informalitetin e përhapur, shkalla aktuale e ndërmjetësimit financiar është e ulët dhe shumë ekonomi familjare dhe firma, ende nuk mbulohej nga institucionet formale financiare. Transaksionet në para të gatshme janë forma dominuese e pagesave në Kosovë, ndërsa pagesat elektronike janë të kufizuara dhe pagesat me mobil praktikisht nuk ekzistojnë.²¹

Sipas indeksit financiar global "Global Findex" të 2017-ës, Kosova shënon qasje nën mesatare në shërbimet financiare në krahasim me VAUM-të e tjera në Evropë dhe Azinë Qendrore. Vetëm 52.3 për qind e popullsisë së rritur në Kosovë posedon një llogari transaksionesh, krahasuar me 65.3 për qind në EAQ. Kjo përkon me faktin se Kosova ka numrin më të ulët të degëve të bankave komerciale dhe bankomatëve për 100,000 të rritur nga katër vendet e programit PRP në Ballkanin Perëndimor.²²

Meshkujt e arsimuar, të punësuarit dhe individët me gjendje më të mirë kanë më shumë gjasa të jenë financiarisht të përfshirë. Pronësia e llogarisë është dukshëm më e ulët në mesin e popullsisë së rritur me arsim fillor ose më pak (42.1 për qind) krahasuar me ata me arsim të mesëm ose të lartë (65.1 për qind). Kosova gjithashtu ka boshllëkun më të madh gjinor në pronësinë e llogarive në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Vetëm 43.7 për qind e grave në Kosovë posedojnë llogari krahasuar me 61.1 për qind të burrave.

Rreth 37 për qind e kosovarëve posedojnë një kartelë pagese, e cila përdoret kryesisht për tërheqjen e parave të gatshme dhe shumë më pak për pagesa me POS ose blerje në internet. Vetëm një e treta e pranuesve të remitancave në Kosovë kanë qasje në një bankomat në afërsi.

Sipas një ankete të BB-së të kryer në vitin 2016,²³ arsyeja kryesore pse pranuesit kosovarë të remitancave që nuk kanë llogari bankare nuk hapin një llogari është besimi i tyre se ata mund t'i menaxhojnë financat e tyre pa një llogari bankare. Pak më shumë se një e katërta e personave pa llogari bankare e konsiderojnë veten shumë të varfër për të përdorur shërbimet financiare ose i konsiderojnë proceset bankare shumë të ndërlikuara dhe konfuze.

Programi i Remitancave dhe Pagesave (PRP)

PRP në Kosovë kishte për qëllim rritjen e qasjes dhe përdorimit të llogarive të transaksionit dhe instrumenteve të pagesave elektronike duke përmirësuar efikasitetin e pagesave vendore me pakicë, me fokus të veçantë në remitancat ndërkombëtare. Si qëllim të fundit, ky program synonte të krijonte kushte për ofrimin e shërbimeve të pagesave më të lira dhe më të qasshme për punëtorët emigrantë kosovarë dhe familjet e tyre dhe popullatën e përgjithshme. Shërbimet e pagesave – në rrethana të caktuara – mund të lehtësojnë qasjen në shërbime të tjera financiare, duke avancuar kështu përfshirjen financiare. Për këtë qëllim, remitancat përdoren si një vektor për shtrirjen e shërbimeve financiare bazë për njerëzit që më parë ishin pa llogari bankare ose "pa bankë".

PRP në Kosovë ka gjashtë fusha kryesore të ndërhyrjes:

- 1) rishikimi i kornizës ligjore dhe rregullatore në përputhje me acquis të BE-së për pagesat me pakicë
- 2) reformimi i Këshillit Kombëtar të Pagesave dhe përditësimi i Strategjisë Kombëtare të Pagesave me Vlerë të Vogël,

²¹ Fondi Monetar Ndërkombëtar. (2020) Departamenti i tregjeve monetare dhe kapitale. Raporti i asistencës teknike-Rishikimi i stabilitetit të sektorit financiar <https://www.elibrary.imf.org/view/journals/002/2020/217/article-A001-en.xml>

²² Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova dhe Serbia.

²³ Grupi i Zhvillimit të Sistemeve të Pagesave i GBB (2016) *Baseline Survey on Remittance Beneficiaries' Financial Behaviors in East Europe and Central Asia* (Anketa bazë mbi sjelljet financiare të përfituesve të remitancave në Evropën Lindore dhe Azinë Qendrore), Washington D.C.: Grupi i Bankës Botërore.

- 3) ofrimi i mbështetjes për BQK-në për të kryer një studim mbi koston e instrumenteve të pagesave me pakicë,
- 4) përkrahja e BQK-së në forcimin e funksionit të mbikëqyrjes së sistemit të pagesave,
- 5) përkrahja e BQK-së në përmirësimin e infrastrukturës së pagesave,
- 6) projekti Greenback

Projekti Greenback

Projekti Greenback synonte të rriste efikasitetin në tregun e remitancave përmes një qasjeje inovative: promovimit të ndryshimeve të frymëzuara nga nevojat reale të përfituesve përfundimtarë të transfereve ndërkombëtare të parave – d.m.th. emigrantët dhe familjet e tyre. Projekti angazhohet drejtpërdrejt me emigrantët dhe përfituesit e remitancave, OSHR-të dhe autoritetet publike për të adresuar nevojat e pagesave dhe ato financiare, që janë specifike për komunitetin nëpërmjet edukimit financiar, ndërgjegjësimit, ngritjes së kapaciteteve të palëve të interesit, angazhimit dhe koordinimit të tregut.

Projekti fillimisht fokusohet vetëm në një komunitet lokal, i cili vepron si një laborator ku analizohen nevojat specifike të komunitetit dhe çështjet që lidhen me remitancat. Duke promovuar bashkëpunimin ndërmjet palëve lokale dhe kombëtare të interesit, projekti kërkoi mënyra për t'i adresuar këto nevoja dhe zgjidhje të shkallëzuara, që mund të sjellin përfitim si nga ana e ofertës ashtu edhe nga ana e kërkesës duke demonstruar se si mund të shfrytëzohen remitancat për të rritur përfshirjen financiare dhe për të promovuar zhvillimin



Greenback 2.0

Në Kosovë, Prizreni ishte përzgjedhur si “Qyteti Kampion” për remitancat në konsultim me BQK-në. Qytetet kampione të remitancave konsiderohen në bazë të numrit të pranuesve të remitancave, madhësisë së diasporës (si dhe lidhjeve që kanë me diasporën), pranisë së sektorit financiar komercial në komunitet dhe disa faktorëve shtesë (p.sh., prania e OJQ-ve lokale, kapaciteti i administratës lokale për të ndërmarrë projekte zhvillimore dhe për t'u ndërlidhur me diasporën, etj.).

Në partneritet me BQK-në, BB-ja zbatoi një sërë aktivitete të Greenback në Kosovë, të cilat njëkohësisht u zgjeruan në disa fronte - angazhimi i drejtpërdrejtë i klientit, ngritja e kapaciteteve të palëve të interesit, angazhimi dhe koordinimi i tregut. Këto rezultuan në si më poshtë:

- (i) sjelljet financiare dhe nevojat e të mësuarit të dërguesve dhe pranuesve të remitancave të analizuar dhe të përmbledhura, duke informuar veprimet e mëtejshme.
- (ii) ndërgjegjësimi i publikut të gjerë dhe i diasporës për rëndësinë e remitancave, përfshirjen financiare, edukimin financiar dhe potencialin e tyre zhvillimor, duke krijuar më shumë fokus në temat dhe duke promovuar ndryshime domethënëse.
- (iii) rritja e kapaciteteve të ofruesve të shërbimeve financiare për të përmbushur më mirë nevojat e klientëve fundorë, kryesisht dërguesve dhe pranuesve të remitancave.
- (iv) programet e ngritjes së kapaciteteve të pilotuara dhe të besuara te palët kombëtare të interesit për të zhvilluar dhe përmirësuar më tej, duke i rritur përpjekjet.

Vlerësimi i tregut dhe nevojave

Banka Botërore kreu një sërë aktivitete të hulumtimit të tregut që ndihmuan në identifikimin e boshllëqeve dhe mundësive për përfshirje nëpërmjet PRP-së dhe projektit Greenback.

Anketa bazë mbi sjelljet financiare të përfituesve të remitancave

Në vitin 2016, BB-ja kreu një anketë bazë²⁴ për të kapur sjelljet financiare të përfituesve të remitancave në gjashtë vende të rajonit të EAQ: Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kosovë, Serbi, Republikën e Kirgistanit dhe Tashkistan. Disa nga gjetjet kryesore nga Kosova janë përfshirë më poshtë. Kjo përkon me faktin se Kosova ka përqindjen më të lartë të familjeve që pranojnë remitanca për më shumë se dhjetë vjet (42 për qind).

Sipas anketës, shumica e dërguesve kosovarë janë meshkuj (82 për qind) dhe gjysma e tyre janë të moshës 30 deri në 44 vjeç. Kosova ka një përqindje jashtëzakonisht të lartë të emigrantëve të përhershëm në mesin e dërguesve të saj (89 për qind), shumica e të cilëve u larguan nga vendi para vitit 2000. Kjo përkon me faktin se Kosova ka përqindjen më të lartë të familjeve që pranojnë remitanca për më shumë se dhjetë vjet (42 për qind).

Shumica e flukseve të remitancave në Kosovë vijnë nga Gjermania dhe Zvicra (më shumë se 60 për qind të kombinuara). Shumica e përfituesve të remitancave nuk pranojnë remitanca çdo muaj por më tepër një deri në gjashtë herë në vit. Shuma mesatare e marrë në një vit është ekuivalenti me 1,858 dollarë ose 560 dollarë për transaksion, që është shuma më e lartë për transaksion në rajon.

Kanali më i përdorur për transferin e remitancave janë OTP-të (45 për qind), të pasuara nga transferet e bëra me dorë nga vetë punëtorët migrantë kur vizitojnë familjen në Kosovë. Dorëzimi personalisht ka më shumë gjasa të përdoret nga familjet, remitanat e të cilave përbëjnë deri në 9 për qind të të ardhurave vjetore të familjes së tyre. Në krahasim me këtë, familjet, remitanat e të cilave përbëjnë më shumë se 20 për qind të të ardhurave vjetore të familjes kanë shumë më shumë gjasa të marrin paratë nëpërmjet operatorëve të transferit të parave. Flukset e mbetura kanalizohen kryesisht nëpërmjet bankave ose në para të gatshme nëpërmjet palëve të treta.

Remitanat përfaqësojnë 23 për qind të buxhetit vjetor të ekonomisë familjare në Kosovë. Remitanat përdoren kryesisht për blerjet e mallrave të konsumit me lëvizje të shpejtë (MKLSH) dhe produkteve të shëndetit dhe higjienës (SHH) (treguar nga 81 për qind e ekonomive familjare të intervistuar), shpenzimeve shëndetësore (58 për qind) dhe qëllimet e arsimit (50 për qind).

Mirëpo, ekziston një dallim i rëndësishëm në pjesëmarrjen e remitancave në të ardhurat totale të ekonomive familjare në mesin e rajoneve të ndryshme në Kosovë. Pësha më e madhe e remitancave në të ardhurat e familjeve është regjistruar në rajonin jugperëndimor të vendit. Anketa regjistroi 41 për qind të familjeve ku pësha e remitancave nga një dërgues është më shumë se 20 për qind e totalit të të ardhurave vjetore të familjeve. Në të kundërt, remitanat përbëjnë më pak se 9 për qind të të ardhurave vjetore të familjeve në pothuajse gjysmën e familjeve të anketuara në juglindje.

Kur u pyetën për nivelin e varësisë nga remitanat, pak më shumë se një e treta e pranuesve kosovarë të remitancave deklaruan se remitanat nuk janë aq të rëndësishme si burim të ardhurash dhe se mund të menaxhohen pa to. Një e treta tjetër mund të menaxhonte pa të, por nuk do të mbulonte të gjitha nevojat e tyre bazë, ndërsa për të tretën e mbetur, remitanat janë burimi kryesor i të ardhurave të familjes së tyre.

²⁴ Grupi i Zhvillimit të Sistemeve të Pagesave i GBB (2016) *Baseline Survey on Remittance Beneficiaries' Financial Behaviors in East Europe and Central Asia (Anketa bazë mbi sjelljet financiare të përfituesve të remitancave në Evropën Lindore dhe Azinë Qendrore)*, Uashington D.C.: Grupi i Bankës Botërore.

Vlerësimi i nevojave për mësim

Me qëllim të identifikimit të boshllëqeve midis anës së kërkesës dhe ofertës për shërbime financiare dhe mundësive për t'i kapërcyer këto boshllëqe përmes aktiviteteve të edukimit financiar, BB-ja organizoi një seri prej dhjetë diskutimesh në fokus grupe me dërguesit dhe pranuesit e remitancave nga Prizreni. Këto sesione u zhvilluan në dhjetor 2018, duke shfrytëzuar festat e fundvitit si një mundësi për të intervistuar emigrantët e kthyer nga zona e Prizrenit.

Metodologjia e fokus grupit mundësoi që modelet e përdorimit, perceptimet dhe nevoja për shërbime financiare të pranuesve të remitancave të analizohen në thellësi. Më konkretisht, arsyetimi prapa kanaleve të preferuara të transferit të remitancave, përdorimet e ndryshme të remitancave dhe qëndrimet ndaj shërbimeve të tjera financiare përvojat me to dhe edukimin financiar u diskutuan me pjesëmarrësit.

Këto sesione vërtetuan gjetjet nga anketa bazë dhe dhanë një kontekst prapa numrave. Raporti i vlerësimit të nevojave për mësim është miratuar zyrtarisht nga BQK-ja në vitin 2019, duke informuar aktivitetet e mëposhtme të edukimit financiar në kuadër të projektit Greenback. Çështjet kryesore që mund të nxirren nga raporti janë renditur më poshtë.

Remitancat janë shumë të rëndësishme për Kosovën dhe diasporën e saj për arsye financiare dhe kulturore. Pavarësisht nga vendi i banimit, lidhja me familjet në vendlindje mbetet e fortë ndër breza dhe emigrantët e vizitojnë të paktën një herë në vit. Anëtarët e diasporës kosovare dërgojnë para në vendlindje vazhdimisht, ndër dekada e breza. Pothuajse çdo familje kosovare ka ndonjë të afërm jashtë vendit, duke pasur parasysh historinë socio-politike të vendit dhe shumë familje marrin mbështetje financiare nga jashtë.

Shërbimet financiare të rregulluara dhe të parregulluara duket se bashkëjetojnë në Kosovë. Emigrantët dhe familjet e tyre vlerësojnë shumë ofruesit e shërbimeve financiare të rregulluara në një masë të madhe. Ata i konsiderojnë ato të shpejta, të besueshme dhe transparente. Megjithatë, disa kanë qenë të papërshtatshme për shkak të problemeve të teknologjisë/sistemeve në banka, gjë që shkaktoi vonesa ose rritje të papritura të tarifave të transaksionit ose tarifave të mirëmbajtjes së llogarisë. Disa thonë se përdorimi i shërbimeve financiare të rregulluara është mjaft sfidues për brezat më të vjetër, të cilët duhet të qëndrojnë në radhë ose të kërkojnë ndihmë për të tërhequr para ose për të kryer një transaksion në bankë.

Zgjedhja e kanaleve të remitancave përcaktohet pothuajse ekskluzivisht nga dërguesi, me pranuesin që ka pak ose aspak ndikim në proces. Dërgimi i parave të gatshme përmes një kanali të parregulluar do të ishte zgjedhja e parë tipike e dërguesve (zakonisht të dërguara me dorë nga një mik, anëtar i familjes ose ndonjë i njohur tjetër ose ndonjëherë nga shoferët e autobusëve), pasuar nga OTP-të (Western Union ose Money Gram) dhe rrallëherë bankat. Emigrantët preferojnë të marrin para me vete kur vizitojnë vendin, sepse zakonisht nuk ka asnjë kosto që lidhet me këtë. Nga ana tjetër, pranuesit preferojnë shërbimet financiare të rregulluara, pasi të pasurit e një historie të dëshmuar të fondeve hyrëse të rregullta mund t'ua mundësojë atyre të hapin mbitërheqje, të marrin kredi, etj.

Dërguesit rrallë përcaktojnë se si shpenzohen paratë që u dërgojnë familjeve të tyre. Kryefamiljari në Prizren zakonisht merr vendimin se si shpenzohen remitancat. Në disa raste, individët më të rinj në familje marrin drejtpërdrejt fonde nga të afërmit e tyre jashtë vendit për t'i mbuluar shpenzimet e tyre, zakonisht për blerjet e tyre të kohës së lirë, si telefona mobilë, kompjuterë ose vetura.

Remitancat përdoren kryesisht për konsum, pagesa të faturave, kujdes shëndetësor, riparim të shtëpive dhe arsimim. Pothuajse të gjithë emigrantët dhe familjet e tyre shprehën hezitim në lidhje me përdorimin e remitancave për qëllime investimi për shkak të kushteve të këqija të tregut (mungesa e fuqisë punëtore të kualifikuar, kërkesa e ulët e tregut, etj.).

Gjeneratat më të vjetra të pranuesve janë më të ekspozuar dhe më të varur nga remitancat. Pjesëmarrësit raportuan se marrin pensione bazë (më pak se 70 euro) dhe disa nuk marrin pension fare. Përveç kësaj, pjesëmarrësit pohuan se nuk ka skemë kombëtare të sigurimit shëndetësor në Kosovë. kështu që ata duhet të paguajnë për shërbimet mjekësore që u nevojiten. Prandaj, të moshuarit janë shumë të varur nga anëtarët e familjes së tyre jashtë vendit për konsum dhe kujdes shëndetësor.

Pothuajse asnjë nga pranuesit e remitançave nuk angazhohet në planifikimin afatgjatë se si përdoren remitançat – asnjë nga pjesëmarrësit e fokus grupit nuk raportoi se kishte kursyer paratë që morën ose që planifikojnë t'i investojnë ato në të ardhmen. Në të njëjtën kohë, pothuajse të gjithë përfituesit deklaruan se gjithmonë do të jenë të varur nga këto të ardhura. Deri më tani, ajo që ata kishin pranuar nuk është përdorur për të zgjidhur çështje të qëndrueshmërisë afatgjatë, si punësimi, vetëpunësimi, etj.

Vlerësimi i tregut të remitançave

Nga shtatori 2018 deri në maj 2019, BB-ja dhe BQK-ja janë takuar me palë interesi të ndryshme lokale dhe kombëtare të cilat ofrojnë, mundësojnë dhe rregullojnë shërbimet financiare. Qëllimi ishte të vlerësohej më tej peizazhi i qasjes në shërbimet e remitançave (afërsia, përballueshmëria, veçoritë e produktit dhe kërkesat e përshtatshmërisë) me të cilat përballen emigrantët dhe familjet e tyre. Këto takime rezultuan të dobishme për të kuptuar mangësitë dhe mundësitë në sektor për t'i përmbushur nevojat e grupit të synuar.

Gjetjet kyçe nga analiza e anës së ofertës ishin si më poshtë:

- (i) Remitançat janë një mundësi e pashfrytëzuar për ofruesit e shërbimeve financiare.
- (ii) Formalizimi i kanalizimit të remitançave është i lidhur ngushtë me përpjekjet për formalizim në ekonominë e përgjithshme.

Përfshirja financiare dhe çështja e besimit

Dërguesit dhe pranuesit e remitançave lidhin kryesisht pronësinë e llogarisë bankare me marrjen e pagës ose pagesën e faturave e jo me transferin e remitançave. Kjo përkon me faktin se, përveç shërbimeve të OTP-ve, ofruesit e shërbimeve financiare nuk ofrojnë asnjë produkt të përshtatur për t'i trajtuar nevojat e menjëhershme të dërguesve dhe pranuesve të remitançave.

Emigrantët përdorin bankat dhe produktet financiare shumë më tepër në krahasim me pranuesit e remitançave. Pronësia e llogarisë individuale nuk shihet si e nevojshme nga disa, veçanërisht femrat e reja, për të cilët prindërit dhe partnerët bëjnë transaksione në emër të tyre, dhe nga individë të papunë që varen pothuajse ekskluzivisht nga remitançat nga jashtë.

Në përgjithësi ekziston një nivel mosbesimi në sektorin financiar në mesin e popullatës lokale. Kur zgjedhin një bankë për të hapur një llogari, pranuesit e bazojnë vendimin e tyre më shumë në këshillat e anëtarëve të familjes ose të të afërmeve, mendimin e të cilëve e vlerësojnë, sesa në informacionin e ofruar nga ofruesit e shërbimeve. Në përgjithësi, besimi te një individ luan një rol thelbësor në vendimmarrjen financiare. Besimi është elementi i vetëm i sigurisë gjatë dërgimit të parave të gatshme në Kosovë përmes shoferëve të autobusëve. Mirëpo, diskutimet e fokus grupeve gjithashtu treguan se ishte shumë e zakonshme që banorët e Prizrenit të lidhnin perceptimin e tyre për një institucion financiar me agjentin ose anëtarin e stafit që i ka ndihmuar ata. Në shumë raste, veçanërisht te klientët e institucioneve mikrofinanciare ose operatorëve të transferit të parave (OTP-ve), pranuesit kishin shumë besim tek agjenti që i ndihmonte dhe i bazonin vendimet në këshillat e tij/saj, Kjo tregon se problemi nuk është domosdoshmërisht mosbesimi në sektorin financiar, por më tepër mosnjohja me e cila rrjedh nga mungesa e njohurive për shërbimet financiare dhe mënyrat për t'i përdorur ato për mirëqenien financiare personale. Nëse dikush nuk mund të mbështetet në burimet e veta kur merr vendime financiare, ai/ajo kërkon një person të besuar për udhëzim, brenda ose jashtë sektorit financiar.

Prandaj, palët e interesit të sektorit financiar mund të kontaktojnë pranuesit e remitançave pa ose me pak llogari bankare dhe të investojnë në edukimin e tyre financiar për t'i forcuar kapacitetet e tyre për vendimmarrjen financiare dhe për të rritur besimin e tyre për t'u angazhuar me ofruesit e shërbimeve financiare. Ky lloj kontakti mund të ndihmojë gjithashtu në ndërtimin e besimit dhe të ofrojë njohuri të mëtejshme për nevojat specifike financiare të këtij segmenti të tregut që duhet të merren parasysh gjatë hartimit të shërbimeve dhe produkteve të përshtatura.

Edukimi financiar për pranuesit e remitancave

Banka Qendrore e Kosovës dhe ofruesit e shërbimeve financiare (bankat komerciale, institucionet mikrofinanciare) dhe shoqatat e tyre janë të vetmit aktorë aktiv në aktivitetet e edukimit financiar në Kosovë. Edukimi financiar konsiderohet nga aktorët nga ana e ofertës si një mundësi jetike e zhvillimit ekonomik. Edhe pse e njohin vlerën e edukimit financiar, ofruesit e shërbimeve financiare përballen gjithashtu me probleme në lidhje me sigurimin e burimeve dhe hartimin e programeve të edukimit financiar.

BQK-ja ka prioritet edukimin financiar të fëmijëve dhe të rinjve në aktivitete të ndryshme në kuadër të Javës Ndërkombëtare të Parasë, Ditës Ndërkombëtare e Fëmijëve, Ditës Botërore e Kursimeve, Ekonomistit të Ri dhe shumë iniciativave të tjera më të gjera të edukimit financiar. Nga ana tjetër, ofruesit e shërbimeve financiare fokusohen tërësisht te klientët potencialë. Në shumicën e rasteve, edukimi financiar ofrohet si "konsulencë individuale" kur një klient potencial dëshiron të përdorë një produkt bankar.



Përpara projektit Greenback, asnjë nga palët e interesit nuk ofroi shërbime të edukimit financiar të fokusuar në mënyrë specifike në remitancat ose të synuara për pranuesit e remitancave ose punëtorët emigrantë. Pjesëmarrësit e fokus grupit e konfirmuan këtë pasi pothuajse asnjë pranues i intervistuar i remitancave nuk kishte marrë pjesë ndonjëherë në ndonjë trajnim për edukimin financiar të ofruar nga ofruesit e shërbimeve financiare ose organizata të tjera.

Edhe pse sfidat e dërguesve dhe pranuesve të remitancave janë të njohura për sektorin financiar, nuk ekziston një strategji kohezive për ndërhyrjet e edukimit financiar. Një strategji kombëtare e edukimit financiar është parë si e nevojshme për të strukturuar punën e edukimit financiar dhe për të sjellë rezultate të matshme. Prandaj, BQK-ja i kërkoi BB-së që të zhvillojë edukim financiar të përshtatur për përfituesit e remitancave në Kosovë, si një nga ndërhyrjet kryesore në kuadër të PRP-së të financuar nga SECO.

Bazuar në gjetjet e tregut dhe të vlerësimit të nevojave, ekipi i BB-së zhvilloi disa lloje të aktiviteteve edukative për BQK-në. Qëllimi i këtyre aktiviteteve është:

- të edukohen dërguesit dhe pranuesit e remitancave dhe grupet e tjera të përjashtuara financiarisht për shërbimet financiare dhe si t'i shfrytëzojmë ato për të përmirësuar mirëqenien financiare personale,
- të rritet profili i remitancave si mundësues i përfshirjes financiare dhe zhvillimit të qëndrueshëm në mesin e palëve vendore të interesit dhe diasporës kosovare, dhe
- të ndërtohen kapacitetet e sektorit të shitjes me pakicë për t'u angazhuar efektivisht në ofrimin e edukimit financiar dhe për të maksimizuar kontaktin me grupet e synuara duke bashkëpunuar me palë të tjera të interesit dhe organizata të specializuara.

Aktivitetet e Greenback

Projekti Greenback u lancua zyrtarisht në Kosovë gjatë Javës Ndërkombëtare të Parasë më 25 mars 2019 dhe pati pasqyrim shumë të mirë në mediat kombëtare. Duke prezantuar iniciativat e BQK-së për edukimin financiar, guvernatori Mehmeti bëri të ditur që ata projektuan projektin Greenback me mbështetjen e BB-së dhe SECO-s, duke pasur si synim remitancat si kategori thelbësore e të hyrave në Kosovë me potencial për t'u transformuar nga të orientuara drejt konsumit në të orientuara drejt investimeve.



Ekipi i Bankës Botërore mori gjithashtu mbështetje zyrtare nga Kryetari i Komunës së Prizrenit dhe Koordinatorin e Qendrës për Edukim Financiar të BQK-së, të cilët në mënyrë aktive e promovuan projektin.

Modulet e edukimit financiar

BB-ja ka zhvilluar pesë module të edukimit financiar për pranuesit e remitancave të cilat mbulojnë (i) kushtet dhe mënyrat bazë të transfereve ndërkombëtare të rregulluara të parave, (ii) tiparet kryesore të shërbimeve dhe produkteve financiare, (iii) shërbimet financiare digjitale, (iv) rëndësinë e remitancave për individin dhe ekonominë dhe (v) rëndësinë e edukimit financiar.

Për të arritur qasje më të madhe dhe lehtësi në përdorim, BB-ja i përshtati materialet në mënyrë grafike dhe i bëri ato të përshtatshme për edukim offline dhe online. Në koordinim me BQK-në, BB-ja publikoi pesë modulet e edukimit financiar në shqip, anglisht dhe serbisht në faqen edukimit financiar të BQK-së.



Moduli 1.
Transferet
ndërkombëtare
të parave.
Konceptet bazike



Moduli 2.
Shërbimet dhe
produktet financiare

BQK Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

2020

REMITTANCES AND THEIR SIGNIFICANCE FOR THE INDIVIDUAL AND THE ECONOMY

The Central Bank of the Republic of Kosovo and The World Bank Group with the support of the Government of Switzerland

THE WORLD BANK
IBRD • IDA | WORLD BANK GROUP

Moduli 3.
Remitancat dhe rëndësia e tyre për individin dhe ekonominë

BQK Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

2020

DIGITAL FINANCIAL SERVICES

The Central Bank of the Republic of Kosovo and The World Bank Group with the support of the Government of Switzerland

THE WORLD BANK
IBRD • IDA | WORLD BANK GROUP

Moduli 4.
Shërbimet financiare digjitale

BQK Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

2020

FINANCIAL LITERACY

The Central Bank of the Republic of Kosovo and The World Bank Group with the support of the Government of Switzerland

THE WORLD BANK
IBRD • IDA | WORLD BANK GROUP

Moduli 5.
Edukimi financiar

Seria e diskutimeve me diasporën për projektin Greenback



Duke përkujtuar Ditën Ndërkombëtare të Emigrantëve më 20 dhjetor 2021, BB-ja dhe BQK-ja organizuan një diskutim online me titull "Remitancat – një udhërrëfyes i zhvillimit" me pjesëtarë të diasporës kosovare në Shtetet e Bashkuara dhe ekspertë të sektorit financiar nga Kosova. Ngjarja promovoi remitancat si një mundësi të përfshirjes financiare dhe zhvillimit të qëndrueshëm dhe nxiti shkëmbimin e informacionit ndërmjet emigrantëve dhe palëve vendore të interesit – familjeve, rregullatorëve dhe ofruesve.

REMITANCAT
NJË UDHËRRËFYES I ZHVILLIMIT

Bashkëbisedim me Diasporën Kosovare në Gjermani

10 Nëntor, 2021

18:00-19:30 (CEST)

Takim virtual në zoom



Diskutimi ishte aktiviteti i pestë dhe i fundit i kësaj serie, i thirrur në bashkëpunim me GERMIN - OJQ që promovon përfshirjen aktive të diasporës shqiptare në zhvillimin e vendeve në Ballkan ku jetojnë shqiptarët. Katër takimet e para virtuale mbledhën pjesëtarë të diasporës kosovare nga Gjermania, Austria, Zvicra dhe Mbretëria e Bashkuar.

Seria e diskutimeve, e cila u zhvillua midis 10 nëntorit 2021 dhe 20 dhjetorit 2021, rezultoi e dobishme për adresimin e boshllëqeve të informacionit në diasporë dhe ndërtimin e urave të shkëmbimit të njohurive ndërmjet emigrantëve dhe palëve relevante të interesit në Kosovë, siç janë ofruesit e shërbimeve financiare, rregullatorët, ekspertët e industrisë, etj.

Akademia Greenback

Në kuadër të Akademisë Greenback, BB-ja organizoi dy sesione trajnimi me përfaqësues të departamenteve të ndryshme në BQK mbi vlerësimin e nevojave, zhvillimin dhe zbatimin e Strategjive Kombëtare të Edukimit Financiar (SKEF) dhe Strategjive Kombëtare të Përfshirjes Financiare (SKPF).

Këto trajnime ndihmuan në ofrimin e një udhëzimi të përgjithshëm për BQK-në se si të mendohet në mënyrë strategjike për promovimin e përfshirjes financiare dhe edukimit financiar.



Inkorporimi i edukimit financiar në kurrikulën e sistemit arsimor

Divizioni i Edukimit Financiar i BQK-së ka kërkuar asistencë teknike në zhvillimin e planeve të veprimit dhe strategjive për edukimin financiar të të rinjve. Ekipi i BB-së bashkoi forcat me Junior Achievement në Shqipëri për të krijuar një kornizë për edukimin financiar, që përmban koncepte dhe aktivitete të përshtatshme për nxënësit e shkollave të mesme në Kosovë.

Korniza shërben si një udhëzues për zhvillimin e programeve të edukimit financiar të orientuar drejt të rinjve. Ofron parime thelbësore, sugjeron tema dhe metodologji specifike që në mënyrë specifike u përgjigjen nevojave mësimore të nxënësve të shkollave të mesme në Kosovë, duke ndjekur parimet e OECD-së²⁵ dhe standardet ndërkombëtare dhe praktikatat më të mira.

²⁵ Drejtorja e OECD-së për Çështjet Financiare dhe të Ndërmarrjeve (2012), OECD INFE guidelines on financial education in schools (Udhëzimet e OECD INFE mbi edukimin financiar në shkolla), Francë: OECD.

<https://www.oecd.org/finance/financial-education/35108560.pdf>

Mësimet e nxjerra dhe rruga përpara

Pavarësisht fillimit të rëndësishëm, zbatimi i projektit Greenback në Kosovë kaloi nëpër disa sfida dhe kufizime të shkaktuara nga pandemia COVID-19. BB-ja dhe BQK-ja punuan intensivisht për të riformësuar aktivitetet e projektit për t'iu përgjigjur nevojave në zhvillim e sipër. Aktivitetet me prezencë fizike u zëvendësuan, aty ku ishte e mundur, me publikimin e materialeve të edukimit financiar përmes kanaleve online, diskutimet dhe forumet u organizuan online dhe aktivitetet e tjera të planifikuara grupore u zëvendësuan me zhvillimin e dokumenteve strategjike dhe trajnimet për BQK-në. Duke pasur parasysh të gjitha gjërat, fleksibiliteti në ridizajnimin e aktiviteteve doli të ishte një pikë e fortë e metodologjisë Greenback. Meqë projekti Greenback ka përfunduar, bërja e tregut të remitancave më efikas duhet të jetë një përpjekje e vazhdueshme në Kosovë. Për këtë qëllim, disa njohuri kryesore nga përvoja me Greenback mund të ofrojnë një shteg të dobishëm për ta çuar këtë punë përpara.



Para së gjithash, edukimi financiar i diasporës dhe rrjedha efektive e informacionit është kritike për minimizimin e kostove dhe rritjen e përdorimit të shërbimeve financiare të rregulluara për remitancat ose edhe më gjerë. Për këtë qëllim, palët relevante të interesit, si rregullatorët, qeveria dhe ofruesit mund të koordinohen për të mbushur boshllëqet e informacionit për të arritur këtë grup të synuar me udhëzime dhe informacione. Kjo mund të arrihet përmes një platforme të dedikuar edukuese dhe informative për diasporën.

Së dyti, për të maksimizuar ndikimin e remitancave në Kosovë, duhet të bëhen përpjekje më të mëdha për të rritur investimet e diasporës në vend në mënyrë të strukturuar. Për këtë qëllim, krijimi i llojeve të reja të instrumenteve dhe produkteve financiare, siç janë bonot e diasporës, mund të jetë një mënyrë për të nxitur investimet në Kosovë.

Së treti, BQK-ja mund të zgjerojë përpjekjet e saj për edukimin financiar të të rinjve duke eksploruar lidhjet me Ministrinë e Arsimit dhe ofruesit e tjerë për të inkorporuar edukimin financiar në shkolla. Iniciativat aktuale të BQK-së për futjen e edukimit financiar në sistemin e arsimit fillor mund të zgjerohen për të synuar shkollat e mesme. Në këtë drejtim, rekomandohet fuqimisht përpilimi i një procesi të kujdesshëm të kujdesit të duhur dhe një vlerësim i domosdoshëm aktual i aftësive ekzistuese financiare të nxënësve të rinj, duke përdorur paraprakisht mjetet dhe metodologjinë ekzistuese të ofruara nga OECD/INFE.

Nga një këndvështrim më i gjerë, përpjekjet për edukimin financiar duhet të shkojnë paralelisht me shërbimet efikase të pagesave për të lehtësuar transaksionet dhe për të rritur besimin në shërbimet financiare të rregulluara. Për këtë qëllim, BQK-ja ka bërë hapa të mëdhenj përpara me kornizën e përditësuar ligjore dhe rregullatore dhe me lansimin e Strategjisë Kombëtare të Pagesave me Vlerë të Vogël (SKPVV).

Së fundi, BQK-së mund t'i duhet të marrë parasysh zhvillimin e një Strategjie Kombëtare të Edukimit Financiar për të promovuar qasje më të madhe në shërbimet financiare dhe përdorim më efektiv të tyre, veçanërisht në dritën e një sektori financiar më të sofistikuar dhe shfaqjes së shërbimeve financiare digjitale. SKEF mund të luajë gjithashtu një rol kritik për t'ia mundësuar qytetarëve përdorimin më të mirë të shërbimeve financiare dhe për të përballuar ngjarjet dhe krizat e papritura.



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO



THE WORLD BANK
IBRD • IDA | WORLD BANK GROUP

The World Bank Group
1818 H Street NW
Washington, DC 20433 USA

www.worldbank.org
paymentsystems@worldbank.org
Telefoni: +1 202 473-1000